



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:096451  
Datë: 26.04.2023  
Numri i dokumentit: 04223563

**SCC-11-0050**

*Paditës*

**R ( A ) H** Malishevë, përfaqësuar nga **Av. Rr K** Prishtinë

*Kundër*

*E Paditur*

1. N “M”, në Malishevë, përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Agim Ramadani” nr. 23 Prishtinë.
2. **Komuna e Malishevës - Malishevë**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga Hajrie Shala gjyqtare kryesuese, Bajram Miftari dhe Agron Hoxhaj, gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me 12 prill 2023, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. Refuzohet si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit R ( A ) H me të cilën ka kërkuar vërtetimin e të drejtës së pronësisë në ngastrën kadastrale nr.44/9 në vendin e quajtur D – R, në sipërfaqe prej 1, 0.17 ha si kultur vreshtë e klasit të 2 dhe e evidentuar në fletën poseduese ZK nr. 72316002 dhe pjesën e ngastrës kadastrale p.nr. në vendin e quajtur D, pyll i degraduar i rexhistruar me shkronjën F1,E , lista poseduese nr. 5 (aktualisht nr. 21) me sipërfaqe prej 1,30.00 ha, me kulturë arë e kl.6 ZK B nr. 72316002 me sipërfaqe të përgjithëshme prej 2,30.17 ha..**

**II. Paditësi ka paguar taksën gjyqësore për padi andaj, nuk ngarkohet me taksë shtesë.**

## **Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me dt.06.06.2006 paditësi kishte ushtruar padinë për vërtetim të pronësisë pranë Gjykata Komunale në Malishevë. Paditësi ka kërkuar njohjen e drejtës së pronësisë për sipërfaqen e ngastrës kadastrale nr.44/9 1.0,17 ha në vendin e quajtur "D – R " dhe pjesën e ngastrës kadastrale nr.21 me sipërfaqe prej 1,30.00 ha, me kulturë arë e kl.6 ZK B nr. 72316002. Paditësi kërkesë padinë e mbështet në faktin se i ati i tij A A H nga Komuna e Malishevës ka qenë pronarë i ngastrave pa nr. lokacion D, sipas kulturës mal i degraduar me sipërfaqe prej 1.0,17 ha e evidentuar në fletën poseduese nr.5 zona kadastrale B. Më tej paditësi deklaroi se paraardhësi i tij ka qenë pronarë edhe i ngastrës kadastrale nr.21 me sipërfaqe 1.30,00 ha me kulturë mal zona kadastrale B e cila evidentohet në fletën e posedimit 167 në vendin e quajtur D "L i Ç" dhe sipërfaqja e gjithëmbarshme e ngastrave është 2,30.17ha.

Paditësi në padi ka theksuar se në vitet 50-ta pushteti i atëhershëm në bazë të ligjeve diskriminuese ka shpronësuar paraardhësin e paditësit dhe këto i ka shëndrruar në prona shoqërore dhe atë pa ndonjë kundërvlerë qoftë në natyrë apo vlerë monetare.

Bashkangjitur padisë, paditësi ka dorëzuar Vendimin e nr.03/2/13 të dt. 1959 i dt. 21. 01. 1959, vendimin e shkallës së dytë R.br.965 të dt. 13.05.1959 , vendimin e dt. 16.04.1959, vendimin e organit administrativ të Kuvendit Komunal të Suharekës të dt. 15.05.1964, procesverbalin e dt.14 04.1969, lista poseduese e vitit 1952 , Ekstrakt nga fletëposedimi nr. 167 e dt. 26.09.2005 dhe certifikata e pronës e dt.10.09.2012

Me dt. 25.01.2011 Gjykata Komunale në Malishevë shpallet jo kompetente për të vendosur lidhur me kërkesë padinë e paditësit R A H dhe lënda i dorëzohet Dhomës së Posaçme me dt.21.02.2011, me ç'rast merr numrin SCC-11-0050.

Pastaj paditësi me dt. 06.08.2012, ushtron Propozim për caktimin e masës së Sigurisë me të cilin kërkon ti ndalohet kundër propozuesit që ti tjetërsoj, ti len nën hipotekë ose ndonjë formë tjetër nën ngarkesë ngastrat kadastrale NR.14/16,82/62 dhe 26/2 me kulturë të gjitha pyll- vendi i quajtur "D" të cilat evidentohen me FP nr.53, ZK B, KK Malishevë. Në pikën e dytë të kërkeses paditësi kërkon që Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës ti ndalohet të bëjë kompenzimin në emër të eksproprijimit për segmentin rrugor nr.5 i aksit rrugor të autostradës V - M. Dhe sipas pikës III, ti ndaloj DGJPK të KK Malishevës që ta ndërroj strukturën e kësaj paluajtshmërie dhe mos të lejoj bartjen e kësaj paluajtshmërie te personat e tretë sipas cilës do bazë qoftë.

Me 13.09.2012 e paditura AKP ushtroi përgjigjen në padi në të cilën i propozoi gjykatës që kërkesëpadija e paditësit R H nga i Malishevës për njohjen e të drejtës së pronësisë në ngastrat kadastrale nr.44,9 dhe nr.21 fleta poseduese nr.167 në sipërfaqe të gjithëmbarshme prej 2.30.00ha ZK B, KK Malisheve, të refuzohet si e pabazuar për shkak të mungesës së legjitimitetit aktiv të palës dhe me aktvendimin 03/2/13 të dt.21.01.1959 është refuzuara ankesa e paditësit dhe nga kjo mund të vërtetohet fakti se vendimi i tillë ka paraqitur aktin Rec Judicata .

Poashtu në përgjigen në kërkesën për urdhër paraprak, mbrojtja i kundërshton të gjitha pretendimet e paditësit të paraqitura në kërkesën për nxjerrjen e urdhërit paraprak gjyqësor duke e konsideruar si të pa bazuar në ligj.

Gjykata me Aktvendimin e 12 mars 2013, kërkesën për urdhër paraprak gjyqësor e refuzoi si e të pa bazuar.

Me 20 janar 2023, gjykata me anë të urdhrit kërkon nga paditësi që ti dorëzoj gjykatës Aktvendimin e trashëgimisë. – të cilin përfaqësuesi e dorëzoj gjatë seancës

Me dt. 17.03.2023 gjykata mbajti seancën gjyqësore, ku përfaqësuesi i paditësit në fjalën e tij deklaroi se mbetet pranë padisë dhe kërkesëpadisë së dt. 03.07.2007 dhe i propozoj gjykatës që të njëjtën ta aprovoj si të bazuar. Ai ka përsëritur pretendimin se paraardhësit të paditësit i është marrë toka me dhunë pa asnjë të drejtë dhe pa asnjë kompensim dhe kjo pronë i është dorëzuar kolonistëve të cilët kanë qëndruar në ato prona deri në vitin 1941. Ndërsa, në vitin 1959 nga Komuna e atëhershme e Suharekës tani territor i Komunës së Malishevës janë marrë vendimet për marrjen e këtyre pronave nga pronarët për krijimin e plantacioneve të ndryshme bujqësore dhe kjo pastaj ka përfunduar në pronë të NSh “M”. Trashëgimlënësi kishte bërë përpjekje të ndryshme në procedura administrative për mbrojtjen e pronës dhe se ka qenë pronarë i këtyre paluajtshmërive e dëshmon lista poseduese e viti 1952 ku prona evidentohet në emte te A (H) H dhe po ashtu dokumenti tjetër i lëshuar me 07.02.1959 nga Këshilli Popullor i Rrethit të Prizrenit Sekretariati për financa me nr.02-897/1-1959. Duke qenë se kjo pronë i është marrë pronarëve në formë jo ligjore që për at kohë ka qenë praktikë i propozojmë gjykatës që kërkesë padinë ta aprovoj në tërësi.

Përfaqësuesi i AKP-së në fjalën e tij shprehi paqartësi në deklarinimin e përfaqësuesit të paditësit i cili nuk u deklarua fare rreth gjendjes faktike aktuale të pronës kontestuese e cila i përket një procedure të filluar dhe përfunduar në procedurë administrative pranë organeve kompetente komunale të vitit 1959 nga shkresat e lëndës rezulton se çështja e kësaj prone kontestuese qysh në at kohë ka përfunduar pas sukses përkundër kërkesave të paditësit, ashtu që pronësia e pronës ka qenë evidente deri ne kohën e shitjes nga AKP që është evidentuar si pronë e NSh-së dhe nga kjo Agjencia nuk ka pas as një arsye që të njëjtën mos ta shes sepse në shkresat e lëndës gjendet Aktvendimi për refuzimin e kërkesës për aprovim të masës së sigurisë nga ana e paditësit dhe mbi këtë bazë mbetet pranë kundërshtimeve të dhëna në mbrojtje dhe i propozon gjykatës refuzimin e kërkesëpadisë së paditësve.

Për detaje tjera referimi bëhet tek dosja e lëndës.

### **Arsyetimi ligjor**

Kolegji gjykues i Dhomës së Posaçme, pas shqyrtimit të përgjithshëm të padisë, dokumenteve dhe provave të mbledhura gjatë gjithë procedurës me shkrim, administrimit të tyre një nga një

dhe në lidhshmëri me njëra tjetrën, vjen në përfundim se padia është e pabazuar dhe si e tillë duhet të refuzohet.

Ne bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Në këtë mënyrë gjykata konstaton se në këtë çështje, nuk është kontestuese se paluajtshmëria kontestuese me aktvendimin e organeve komunale i është eksproprijuar-shpronësuar paditësit pa kompenzim. Poashtu, nuk është kontestuese se paditësi në procedurë administrative ka ushtruar kërkesë për kthim të pronës por, me vendimin e komisionit të atëhershëm popullor 03 -2/13 të dt. 21.01.1959 kjo kërkesë nuk është aprovuar, me arsyetimin se pronat e uzurpuara gjenden në masë të pronës së përgjithshme popullore. Poashtu duke vendosur sipas ankesës së paditësit ndaj këtij vendimi, shkalla e dytë me vendimin e R.br. 965 të dt. 13.05.1959, e ka refuzuar ankesën si të pa bazuar.

Në kuptim të vërtetimit të gjendjes së fakteve gjykata vlerësoi pretendimet e paditësit i cili kërkesën e tij e mbështet në listën poseduese të viti 1952 dhe në ndjekjen e procedurave për anulimin e vendimeve për realizimin e të drejtës në pronën që më parë ishte e tij, duke konsideruar se drejtësia e asaj kohe ka qenë e kushtëzuar, me ç'rast i është refuzuar ankesa në kundërshtim me të drejtën ndërkombtare. Për gjykatën ky pretendim nuk ishte kontestues, mirëpo trashëgimlënësi i paditësit ka ndjekur procedurën administrative për kthimin e pronës, mirëpo nuk kishte pasur sukses.

Paditësi nuk e ka mohuar faktin se kjo pronë kontestuese ka pësuar ndryshime të vazhdueshme duke marr numra të rinj kadastral dhe pronar të ndryshëm por, gjithëherë në emër Organizatave Shoqërore Punuese për tu futur në kompleksin si ngastër me nr. 44/9, në vendin e quajtur "D – R", kulturë e kl. të 2, në sipërfaqe prej 1,0.17 ha, kulturë e klasit të 2 sipas fletëposedimit nr 167 ZK nr. 72316002 – B si dhe i ngastrës kadastrale në vendin e quajtur Dubrava sipas kulturës mal

i degraduar me nr. të fletës poseduese nr 5 sipërfaqe prej 1,30.00 ha ZK B e që tani e evidentuar në fletën poseduese nr.167 nr. të posedimit 21 në vendin e quajtur D –L i Q dhe kërkesë padia ka të bëjë me sipërfaqen e përgjithëshme prej 2,30.17 ha që evidentohen në emër të O “M”.

Nga përshkrimi i historikut të kësaj prone, gjykata gjen se paditësi nuk e mohon faktin se pronat e kontestuar për kohë shumë të gjatë kanë qenë në pronësi shoqërore dhe përfundimisht në emër të NSH Mirusha .

Andaj, e paditura në mbrojtje me të drejtë ka theksuar se kjo çështje juridike ka përfunduar në procedurë administrative dhe se paditësi që nga viti 1959 kur i është refuzuar ankesa ndaj aktvendimit 03.nr/13 i dt. 21/01.1959 më nuk ka pasur qasje në pronë. Në atë kohë, trashëgimlënësi i paditësit nuk ka paraqitur padi kundër vendimeve administrative të lartpërmendura , ashtu që vendimet e tilla kanë mbetur në fuqi prej asaj kohe dhe janë në fuqi edhe në ditët e sotshme dhe se tashmë kanë kaluar të gjitha afatet e mundshme ligjore për goditjen e tyre.

Nga të cekurat më lartë rezulton se paditësi nuk ka ofruar dëshmi relevante për të vërtetuar faktin se i takon e drejta e pretenduar pra i njëjti nuk ka dorëzuar asnjëherë certifikatë pronësie nga e cila do vërtetohej se paraardhësi i tij ka qenë pronar juridik i ngastrave kontestuese pas vitit 1959. Ai ka prezentuar listat poseduese por, që të njëjtat ishin të vitit 1952, që vërteton faktin se paraardhësi i tij vetëm para vitit 1959 e ka pas në posedim pronën kontestuese.

Në drejtim të vërtetimit të gjendjes faktike gjykata vlerësoi edhe faktin se certifikata e pronës e dt.10.09.2012 për parcelën P-72316002-00024-25 është në emër të M H nga Prizreni si shfrytëzues i saj me qirambajtje për 99 vite, të cilën ankuesi e kishte kontestuar por, nuk kishte ofruar asnjë provë për ta kundërshtuar gjendjen faktike të tanishme.

Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e paditësit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paluajtshmërinë e eksproprijuar, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës paditëse dhe të paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenin 54.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

### **Taksat gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Paditësi e ka paguar tasksën gjyqësore për padinë e parashtruar.

### **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

**Hajrie Shala**, Gjyqtare kryesuese

**Bajram Miftari** , Gjyqtar

**Agron Hoxhaj** , Gjyqtar